



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.509/2021

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Afijete Sada-Gllogjani kryesues, Milena Đerić, dhe Zyhdi Haziri anëtarë, me zyrtarin ligjor Faton Xhaqkaj, duke vendosur lidhur me ankesën e Birn dhe Internews/Kosova I/KS, kundër, Komisionerve të Vendvotimit 2809B, në fshatin Qabër Zubin Potok, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen me datë 14.02.2021, në seancën e panelit të mbajtur me 16.02.2021, mori këtë:

#### V E N D I M

Hudhet e palejuara ankesa Anr.509/2021 i datës 15.02.2021, e ushtruar nga Organizata Joqeveritare Birn dhe Internews/Kosova I/KS, kundër Komisionarëve të Vendvotimit 2809B, në fshatin Qabër Zubin Potok, që ka të bëjë me ditën e votimit.

#### A r s y e t i m

Paneli, me datë 15.02.2021, ka pranuar ankesë: Anr.509/2021 i datës 15.02.2021, e ushtruar nga Organizata joqeveritare Birn dhe Internews/Kosova I/KS, e cila ankesë paraqitur kundër Komisionerve të Vendvotimit 2809B, në fshatin Qabër Zubin Potok, që ka të bëjë me ditën e votimit. Në ankesë pretendon se gjatë ditës së zgjedhjeve me datë 14 shkurt 2021, rreth orës 15:00, qytetari Fefzi Hasani ka shkuar në vendvotimin 2809B, në fshatin Qabër Zubin Potok, mirëpo nuk është lejuar të votoj përkundër që KQZ, ka njoftuar që edhe personat me dokumente, me afat të skaduar mund të votojnë.

Paneli, pasi që shqyrtoi lejueshmërinë e ankesës, gjeti se:

#### **Ankesa është e palejueshme**

Paneli pas shqyrtimit me kujdes të ankesës Anr.509/2021 i datës 15.02.2021, erdhi në përfundim se e njëjta është e pa lejueshme. Në rastin konkret ankesa është bërë nga Organizata Joqeveritare Birn dhe Internews/Kosova I/KS si person i pa autorizuar dhe jo nga personi ndaj të cilit pretendohet shkelja e supozuar.

Gjithashtu ankesa e ushtruar nga Organizata Joqeveritare Birn dhe Internews/Kosova I/KS, bie në kundërshtim me LZP-së nr. 03/l-073 - Ligji nr. 03/l-

256 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/l-073 për zgjedhjet e përgjithshme në republikën e Kosovës, përkatësisht neni 119 par,1, me të cilin përcaktohet se: 119.1 *Personi i cili ka interes ligjor në një çështje brenda juridiksionit të PZAP-it, ose të drejtat e të cilit janë shkelur për sa i përket procesit zgjedhor të rregulluar sipas këtij ligji ose rregullave zgjedhore,, mund të paraqesë ankesë PZAP-it brenda 24 orëve nga momenti i mbylljes së qendrës së votimit, dhe PZAP-i do të vendos për ankesën brenda 72 orëve nga koha kur është pranuar ankesa.* Nga kjo shihet qartë se ankuesi nuk ka interes ligjor dhe juridik në çështjen konkrete, pasi që shkelja e supozuar, pretendohet për personin Fefzi Hasani, i cili ankesën është dashur ta paraqes personalisht, me pretendimet konkrete për shkeljet e supozuara, kjo për faktin se shkelja e supozuar të drejtën e ankesës e ka vetëm personi ndaj të cilit janë shkelur të drejtat.

Paneli duke u mbështetur në Rregulloren Nr.02/2015, përkatësisht neni 6.4, me të cilën përcaktohet se: *“ankesa të cilat janë të pa lejuar dhe të pas afatshme PZAP-i, i hudhë si të pa lejueshme”*. Në rastin konkret ankesa është e palejueshme për faktin se nuk është ushtruar nga personi ndaj të cilit është pretenduar shkelja dhe si e tillë duhet të hudhët poshtë si e pa lejuar.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me nenin 119 të LZP-së dhe nenin 6 paragrafi 4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr.02/2015, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
Anr.509/2021 datë 16.02.2021

**Kryesuese e Panelit**  
Afijete Sada-Gillogjani



**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa, duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 4 i LZP-së,